



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 12.05.2023

Nr: 109

Ora: 14:35

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 31, DATË 12.05.2023 TË KOMISIONERIT  
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**OBJEKT:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Rakip Suli, kryetar i bashkisë Kamëz dhe z. Blerim Shera, kryetar i bashkisë Vorë.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

### **VËREN:**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 31 regj., datë 12.05.2023. Në mbledhjen e datës 12.05.2023, ora 14:35, pas relatimit të z. Koli Bele, u konstatua se kërkesa i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 31, datë 12.05.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 15.05.2023, ora 14:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	- <b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	- <b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	- <b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	- <b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	- <b>Anëtar</b>

Data: 12.05.2023 Nr: 109  
Ora: 14:35



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 31,  
datë 12.05.2023”